REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

REFERENC-Ë:	Numër 02-06/26
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Leonard Llolluni - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	30.06.2026
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së gjashtë (6), të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 30.06.2026, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Leonard Llolluni: i cili në fillim përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë, më pas e konstatoi se prezent ne sallën e kuvendit janë 11 anëtarë të Kuvendit të Konunës së Junikut.

Anëtarët prezent:

1. Leonard Llolluni-Kryesues,AAK
2. Bedrush Hoxha-anëtar,LDK
3. Litafete Isufaj-anëtare, LDK
4. Shpejtim Gacaferi- anëtar, LDK
5. Sadri Krasniqi- anëtar, LDK (Mungon)
6. Floris Miroci-anëtar, LDK
7. Blerta Syla-anëtare, LDK
8. Burim Kuçi-anëtar, AAK
9. Ajshe Gacaferi-anëtare, AAK
10. Aldi Gacaferi-anëtar, AAK (Mungon)
11. Arlinda Pepshi-anëtare, AAK (Mungon)
12. Alfred Gaxherri-anëtar, AAK
13. Jetmir Tofaj-anëtar, LVV (Mungon)
14. Elsa Hima-anëtare, LVV

15. Lulzim Gacaferi-anëtar, LVV

Rendi i ditës i paraparë

1. Shqyrtimi dhe Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2026,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për vitin 2027/2029, për Komunën e Junikut,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave PNMIM, për pesë Komunat e Rajonit të Dukagjinit,
5. Rishqyrtimi i Vendimit me nr:2-180/3155, per miratimin e plotësim ndryshimit të projekt-rregullores për menaxhimin e mbeturinave, miratuar nga Kuvendi i Komunës së Junikut,
6. Raportimi i procesit të legalizimit, si dhe vendimi i Ministrisë për zgjatjen e afatitit të legalizimit për vitin 2026,
7. Të ndryshme

Para rendit të dites

z.Lulzim Gacaferi, përshendetje për të gjithë, z.Kryesues se pari unë kërkoj që të na krijohen kushte për mbajtjen e kësaj mbledhje, gjendja në sallë është për të ardhur keq, tavolinat janë të mbushura me pluhur, dyshemeja është e mbuluar me pluhur, a jemi ne këtu institucion, apo jemi në një shtallë të lopëve? Organet përgjegjëse të Komunës duhen ta marin seriozisht Kuvendin e Komunës së Junikut, e nëse nuk e kryejn punën e vetë të shkojnë në shtëpi.

z.Leonard Llolluni, me të vërtetë edhe unë e pashtë, mirëpo me qenë se i kemi disa pika të rëndësishme për shqyrtim pranova ta vazhdoj mbledhjen, sepse sot me të vërtetë nuk kemi pasur kushte të vazhdojmë me mbledhjen e rregullt të Kuvendit, mirëmbajtja e sallës së Kuvendit është detyrë e ekzekutivit, unë nuk jam ekzekutiv dhe dikush nga ta mund të na jepe pergjigje për gjendjen e salles së kuvendit.

znj.Leonora Shehu, përshendetje për të gjithë, ne kërkojmë nga ju mirëkuptim për gjendjen e salles, siç po e shinni jemi në fazën e punimeve, nëse mundeni me e mbajtë mbledhjen, e di se kushtet nuk janë të favorshme por jemi në fazen e punimeve, andaj kërkoj mirëkuptimin e juaj.

z.Lulzim Gacaferi, e nderuara drejtoreshë, ne kuvendarët vimë këtu ta kryejm punën tonë me nderë për vednin tonë, ju jeni drejtoreshë, ju jeni ekzekutivi dhe duhet ta merni seriozisht punën që e beni, duhet te na krijoni kushte që ne te mbajmë mbledhjen, është dashur që para mbledhjes të sjellni pastruse dhe ta rregullojnë sallen per mbajtjen e mbledhjes, për ketë mos punë jame jashtëzakunisht i zhgënyerë.

z.Demokrat Ganijaj, përshendetje për te gjithë, unë jam implemetues i këtij projekti dhe ndjej obligim me ju kërkuar falje secilit, punimet ende janë duke vazhduar, nese e kishim pastruar para séance, punime do të ketë prap prapa seancës, por unë besoj se ne seancën e radhës do të kryhen punimet së paku për sallën e e Kuvendit dhe nuk do ta keni më në ketë gjendje, por prap sinqerisht ju kërkoj falje dhe pres mirëkuptimin e juaj, nuk është diçka e qëllimtë por janë duke vazhduar punimet në terë objektin e komunës.

z.Lulzim Gacaferi, nuk keni nevojë ta luani rrolin e avokatit, komuna jonë ka zyra alternative në katin e dytë për mbjtjen e kesaj mbledhje, andaj duhet të na krijoni kushte, nuk jeni për të ju falur, nuk ju vie turp të na sillni ne sallë në ketë gjendje thuaja se ne jemi shtazë, nëse ju nuk jeni në gjendja ta mirëmbani sallen e kuvendit per nje mbledhje ateher shkoni në shtëpi.

z.Leonard Llolluni, kthehemi te rendi te dites, a do dikush te diskutoje rrethe rendi te dites.

z.Shpejtim Gacaferi, pershendetje për të gjithë, para se ta votojmë rendin e ditës kërkoj sqarim lidhur me pikën e 6, sqarim o nga ju, o nga parashtruesi i kërkesës.

z.Zenun Shala, përshendetje për të gjithë, ne si drejtori duam qe vetëm të raportojmë para Kuvendit për ligjin e legalizimit ë cili është në fuqi që nga viti 2023 dhe është vazhduar prap në vitin 2026, po duam që për te sensibilizuar përmes kuvendit, sepse kemi interesim te vogël nga qytetaret për të legalizuar objektet e banimit.

z.Leonard Llolluni, e qes ne votim rendin e ditës, kush është për? Për 10 vota, kundër 1 votë, dhe abstenim 0 vota, konstatoi se rendi i dites u miratua.

1. Shqyrtimi dhe Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z.Shpejtim Gacaferi, një permirësim të vogël te fjalia ime në faqe numër 3, te fjalia, “si material na edhe pak me vonesë, unë kam thenë: si material, na erdhi pak me vonesë, vetëm kjo të përmirësohet.

z.Leonard Llolluni, kjo do të përmirësohet nga ana e procesmbajtësit, nëse ska kerkesë tjetër unë e qes në votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar, kush është për? Për 10 vota, kundër 1 votë, dhe abstenim 0, konstatoi se procesverbali i mbledhjes së muajit Maj 2026 u miratua me atë përmirsimin e cekur nga z.Shpejtim Gacaferi.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Keshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2026,

Sqarimin dhe arsyetimin e Planit të punës se kKSB_se e bëri kordinatori i këtij këshilli, nënkryetari i komunës z.Besart Tofaj, i cili fillimisht i përshendeti të gjithë më pas e arsyetoj planin e punës para kuvendit.

z.Shpejtim Gacaferi, kur po e pranon nenkryetari neglezhencen, mendova se është ka e pranon neglizhencen për vonesen e këtij plani të punës, nuk e dita se po do me pranu neglizhencen për kushtet këtu ne kuvend, ky plan ka ardhur me shum vonesë , jemi në mesin e vitit dhe deri tani ky këshill ka mbajtur 3 takime qe për ketë vit i ka te parapara gjithësejtë 6 takime.

z.Lulzim Gacaferi, faleminderit nënkryetar qe po tregohesh më i sinqertë se kolegët tuaj nga ekzekutivi, por kjo temë u fol mjaftë tashmë, por sidoqoftë dua te ndërlidhem me çështjen që ti prezentove. Të siguria në trafik, sinjalizimi, sanimi i rrugëve dhe ndriçimi publik, duke ë perfshirë edhe parkingjet ku ta di unë, ne sot e patem një debat me policinë e Junikut, në lagjen tonë patëm të pame për të ndjerin z.Faik Tofaj ë cili vdiq në moshë të re dhe me te cilin jam rritur, për ngushëllime kanë ardhur nga qeveria e Kosovës, iste zëvendsministri z.Agon Batusha me stafin e tij përcjellës, nëse për ngushëllime vinë nga ekzekutivi per të na nderuar dhe policia e Junikut sjellen në mënyre të ashpër dhe nuk e rrespektojnë kodin e sjelljes, duke ofenduar të gjithë duke me perfshirë edhe mua si i zgjedhur nga qytetarët në kuadër të kuvendit të Junikut, ju e keni cekur në ketë plan se ekziston një parking për automjete , a në anën tjetër jepni udhëra që policia ti gjobisë qytetarët e Junikut, qytetarët e këtij vendi ateherë i vendosni se paku shenjat e komunikacionit që qytetarët që vinë nga jashtë Junikut të jenë në dieni që ku është e ndaluar parkingu i automjetit, sepse nga shtatorja e “Edmond Hoxha” e deri tek stacioni i autobusëve nuk ka asnjë shenje per ndalim parkingu per vetura, ju si ekzekutiv e keni pergjesi qe keto shenja ti

vendosni, por njekosishte te keni mundesinë që qyetarët që vinë për çfar do sherbimi të kenë mundësinë që ta parkojnë automjetin.

z.Besart Tofaj, policia e Kosovës e ka hiarkinë e vet, ne nuk jemi organ mbikëqyrës dhe as punëdhënës të asnjë polici, e kanë Komandantin eStacionit këtu në Junik, komandantin regjional dhe deri te ministri dhe atyre ju raporton dhe po ashtu kanë edhe inspektoriatin ku mundeni mi adresuar ankesat, dhe unë mendoj se ligji duhet te jet i njëjtë për të gjithë pavarsisht a është zyrtarë komunal apo shtetëror apo qytetarë pa ansjë funksion, hapësira për trotuare është hapësirë e dedikuar për këmbësorë, mundet të ketë ndonjë shenjë të dëmtuar por kryesishtë shenjat janë të vendosura, ndersa sa i përket çështjes të ngitur nga z.Shpejtim Gacaferi, është e vërtetë që ne deri tani kemi mbajtur dy mbledhje deri tani, sepse edhe themelimi i këtij keshilli KKSB, ka ndodhur ashtu siç e sheh mandati i Kuvendit Komunal.

z.Lulzim Gacaferi, u tha se ka shenjat qe e ndalojnë parkingun e automjeteve, unë isha kureshtar pas atij rasti që të shiqoj se a ka por nga shtatorja e “Edmond Hoxha” e deri te autolarja e z.Besnik Gacaferi nuk ka shenjë të vendosur, poashtu nuk thash që të perziheni në kompetencat e policisë, por thash se ju jeni ekzekutiv dhe keni për detyrë që ti vendosni ato shenja ,jo policia.

z.Burim Kuçi, pershendetje per te gjithe, eshte mire qe komuna te gjeje hapësira ku qytetarët të kenë mundësi ti parkojnë automjetet, ku dihet se tashmë vinë edhe diaspora, nëpër trotuare nuk guxojmë ti parkojmë automjetet, atëherë ku ti lejmë? Andaj unë kerkojë nga Komuna që të shiqoj mundesitë që qytetarët qe kur të vinë në qendër të Junikut të kenë mundësitë ku ti parkojnë automjetet.

z.Leonard Llolluni, kerkese tjetër nuk ka unë e qes në votim planin KKSB-se, kush është për? Per 10 vota, kundër 1 votë dhe abstenim 0 vota, konstatoi se plani i KKSB_se për vitin 2026 u miratua.

3.Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për vitin 2027/2029, per Komunen e Junikut,

Sqarimin dhe arsyetimin e kornizes Afatmesme Buxhetore per vitn 2027/2029 e beri znj.Ardita Hoxha-drejtoreshe ne DBF, e cila fillimisht I pershendeti te gjithe me pas e sqaroi dhe arsyetoi para kuvendit kete Kornizen Afatmesme Buxhetore 2027/2029.

z.Shpejtim Gacaferi, ndryshimi programit komunal i investimeve publike na edhe pse pak me vonesë, me gjithëatë unë në materialin që na ka ardhur më herët e pata perpunuar dhe i pava disa mangësi apo diçka që janë hequr apo është dashur të hiqen, nuk po i diskutoj, drejtoresha na tha se se cilat janë hequr dhe cilat janë shtuar, dhe nuk mundem ta percjellim se na u tha pakë shpejtë, në faqe 20 numër 17, rregullimi i qendres inovative multifunksionale shtepija e kulturës janë paraparë për dy vitet e ardhshme 900000€, kjo më pëlqej mirëpo lokacioni se ku do të ndërtohet nuk e keni, numër 48, ndërtimi objektit të policisë për vitin 2027-2028 janë paraparë gjithsejt 400000€, dhe kjo mendoj se duhet të hiqet, ndoshta edhe është hiqur nuk e di, sepse ky projekt është në përfundim e sipër, pastaj numer 78, nese nuk e keni përsëritur diku tjetër, ndërtimi i pikave vrojtuse panoramatike, numër 92, ka qenë e paraparë hapja e rrugës fushore duhet te jete hapja e rrugës malore lokacioni qafa e Jasiqit-Fierzë me sa pashe ky projekt ishte hiqur, ndoshta keni ndonjë arsye, numër 108, rikostruimi i rruges "Shkelzen Gacaferi" per vitin 2027 janë paraparë 100000€, nëse nuk e keni kaluar diku tjetër dhe në qoftëse ësht hiqur unë ju ftoj ta vendosni prap, nuk ka rëndesi në qfare numri e vendosni, dhe kisha kërkuar që ato 100000€ që kanë qenë të parapara ne PIP për vitin 2027 ne muajin Shtator te na vinë të parapara në buxhet, poashtu kërkoj që në PIP të shtohen edhe rregullimi i kanalit për ujitje, "kanali i Zhubit" ashtu quhet, i cili është jo funksional qe nga koha kur është berë rregullimi shtratit te lumit Erenik.

z.Leonard Llolluni, unë nuk e di se ka ardhur material shtesë për ketë pikë, tash po e di se ka një material shtesë.

z.Arten Hamza, përshendetje për të gjithë, sa i përket PIP, materiali qe ju e keni pasur ka qenë njëjti që është debatuar ne mbledhjen e KPF_se, projekte qe jane aprovuar projekt qe kane qene ne KAB e vjeter, ne gjate kesaj faze jane mbajtur ndegjime publike dhe kemi patur kerkesa nga qytetaret qe te perfshihen në KAB, drejtoresha ka sjellur këto çka ne i kemi ofruar si propozim nëse ju si kuvend doni ti përfshimë në KAB_in aktual apt ne KAB_in e kaluar mi lenë deri në shtator, KAB_i aktual mund te pesoj ndryshime deri ne shtatore, ju e dini se I kemi edhe dy ndegjime tjera te planifikuara, po ashtu e ka te planifikuar edhe nje ndegjim KPF_ja ne shtatore , atehere lista e projekteve ne shtatore do te jete filane, keto jane vetem propozime, ato çka jane hiqur kane qene projekte te dyfishta, dhe rruga "Shkelzen Gacaferi" nuk eshte hiqur eshte ne kuader te listes por mund te gjeni te renditur diku tjeter, te hiqura jane vetem ato projekte qe jane te perfunduara dhe ato projekte qe jane te dyfishta, ndersa ato që janë në process siç është projekti i stacionit policor edhe projekti këtu ne objektin e komunës që janë të parapara , figurojnë ende sepse janë ne process dhe nuk janë të përfunduara dhe nuk hiqen derisa të bëhet dorëzimi final.

z.Burim Kuçi, edhe ne i kemi shikuar këto projekte që janë në PIP, unë deshta me u ndal te top projektet qe i ka parapar komuna, po shoh ketu ndërtimi i ndrçimit publik në rrugët lokale, ndërsa pikerisht në lagjen Gaxherr ne rrugën "Jaruha", janë disa shtëpi që nuk kanë rrymë as trefazzore e kta folin për ndriçim publik, unë kërkoj që kjo lagje të hynë ne top projektet që këto shtëpi te kenë rrejtin elektrik trefazor ashtu siç e kemi ne gjithe pjesa tjetër e komunës së Junikut, poashtu e pashë projekti këndi lojrave për femijë ne lagjen "Berishë", është e vërtetë që ka nevojë edhe kjo por kisha kërkuar që me mirë të bëhet rikostruimi i shtratit Erenik, me futur si top projekt sepse të gjithë e dimë se sa është dëmtuar shtrati i lumit Erenik nga vërshimet që kishim.

z.Lulzim Gacaferi, po ndërlidhem me projektin që ka të bejë me lagjen nga vi, lagjen "Gacafer", z.Shpejtim Gacaferi e ceki kanalin për ujitjrn e tokave siç e quajmë ne kanali i "Zhubit", po du te di se kur te do të ndërtohet ky kanal, keni ndërtuar 4500m kanal për ujitje për njerzi që meren me tregti dhe nuk meren me bujqësi ndërsa në lagjen Gacafer i ke shumë bujqër qe meren me ketë lami dhe janë të varur nga kjo, pse deri tani nuk jeni marë me ndërtimin e këtij kanali, ju keni ndërtuar kanal te ujitje per zyrtarë komunal qe skan asnjë bagëti dhe as qe meren me bujqësi, poashtu projekti qe ka filluar ne ketë lagje kur do te përfundoj, në vitin 2024 unë e kame votuar buxhetin pikërisht për ketë projekt, poashtu edhe per projektin e rruges për te lapidari i Deshmorëve të Luftës së "Zharres", deshmorëve Shkelzen Gacaferi, Avdyl Jasiqi dhe Arif Gjocaj, po ashtu nuk keni paraparë te ndërtohet rruga për bjeshkën e Gacaferit që për momentin është shumë e dëmtuar dhe para se të ndodhë ndonjë fatkeqësi pse nuk parashihni ndërtimin e saj, a ktu na prezentoni se keni ndërtuar ndriçimim jo kta jo ata, në rregull keni ndërtuar ndriçimin por keni ndërtuar për marre të zotiti, çdo 50m keni vendosur shtylla të ndriçimit, a në anen tjetër nuk e keni paraparë se sa shpenzojnë dhe e dëmtojnë buxhetin komunal, poashtu e keni lenë qendren e Junikut pa ndriçim publik, që eshtë pasqyrë e Komunës tonë, ky është viti i pestë dhe nuk i keni berë këto punë andaj ikni prej ketuhit se ne e marim në dorë sepse ne dimë te krijomë politika parimore në shërbim të qytetarit në sherbim të komunës, nuk punohet duke ndejtur në kafe, çdo ditë i ke në kafeteritë "Friends" dhe "nShekull" zyrtar komunal duke ndejtur në orar të punës çka është kjo gjendje kështu?!

z.Alfred Gaxherri,përshendetje për të gjithë, mirë që e ceki z.Lulzim Gacaferi se partia LVV ka qenë që në vitin e kaluar ka mndësuar që të votohet buxheti, pikerisht për ndërtimin e rrugës për "Zharre", ne nuk kemi marë pjesë në votim të këtij buxheti për të vetmen arsyje se e kemi ditur se nuk do të ndërtohet ajo rrugë dhe me 31 Tetor Kryetari i Komunës, z.Ruzhdi Shehu na ka fajësuar se për mos votimin e buxhetit jemi duke shkelur mbi gjakun e dëshmorve, e ne pyesim se ku është ndërtimi i asaj rruge dhe pse ende nuk është bere asgjë për të, dhe as qe është i paraparë për asnjë vit, poashtu dua të ndërlidhem me ujëjellsin në Lagjen "Agim Ramadani" qe sa vite eshte projekt qe eshte kerkuar me se shumti ne kete kuvend, as qe jeni mare me kete projek dhe as qe eshte i futur si projekt per te ardhmen, eshte shume e domosdoshme qe ky projekt te futet si primare per kete vit dhe per vitet e ardhshme.

z.Bedrush Hoxha, përshendetje për të gjithë, unë kërkoj nga drejtori i drejtorisë për arsim, kulturë, rini dhe sport, qe ta merë në konsideratë kërkesën që kemi berë për restaurimin e kullës se "Nurë Hoxha", dhe te "Kroni i Hoxhaj", janë në mbrojtje të trashëgemisë kulturore.

znj.Litafete Isufaj, përshendetje për të gjithë, interesimi im ka të bejë për rrugën në lagjen "Moronica", nga ura e Erenikut e deri te kulla e madhe në Moronicë, nga dita ne ditë nga reshjet e shiut ka grryerje të rrugës, pikërisht më së shumti është duke ndodhur afër kullës së madhe mu në kthesë, edhe në mbledhjet e kaluara kam kërkuar që në ketë pjesë të intervenohet të bëhet hapja e një kanali për ujrat atmosferike,unë kërkoj që ta futni si projekt, asfaltin nga ura e deri te kulla te rinovohet poaashtu tr bëhet hapja e kanaleve për ujrat atmosferike përgjatë kësaj rruge.

znj.Ardita Hoxha, unë kërkoj që te merni pjesë ne dëgjime publike e ti propozoni këto projekte, poashtu ka projekte që janë të buxhetuara për ketë vit edhe pse janë të përfunduara nuk mund ti heqim nga lista, pasi qe te perfundojnë ne i heqim nga lista, poashtu projektet nga numri 1 deri ne 11 janë projekte që do të ekzekutohen.

z.Lilzim Gacaferi, e nderuara drejtoreshë e di se nuk ke eksperiencë në instutconet lokale, e vlersoj guximin që ta pranosh punën të jeshe drejtoreshë, por duhet ta dini se kjo është një përgjegjësi shumë e madhe, ju skeni të drejtë të na thoni të marim pjesë në dëgjime publike sepse ne jemi të zgjedhur nga populli, ne jemi duke berë punen tonë, por juve ju sygjeroj ti kryeni punët tuaja, por ju nuk jeni të aftë, i terë stafi komunal nuk jeni të aftë të kryeni punen e juaj, por mund te vini te ne, e ne ju nxerrim prej krizave siç ju kemi nxerrur shumë here nga krizat.

z.Burim Kuçi, ndëgjimet publike janë vetëm sa per sy e faqe, a mundndeni të më tregoni një projekt qe ka propozuar një qytetar dhe e keni futur në ketë listë, poashtu kërkoj që përgjatë lumit "Erenik" më saktësisht në lagjen "Berishë të futet si projekt ndriçimi publik ku dihet se tash vinë bashkadhetarët dhe ajo pjesë frekuentohet me të madhe nga qytetarët, dhe po ju them se nese nuk përfillen këto kërkesa që ne i parashtrojmë këtu, nuk do ta keni perkrahjen tonë në të ardhmen.

z.Zenun Shala, sa i përket rrugës për Zharre, për te lapidari i dëshmorëve, ky tender ka qenë i hapur, dhe mbrenda dy apo tri ditëve do të fillojnë punët në ketë rrugë, në atë rrugë janë disa përroje të vogëla që kërkohet të intervenohet me gypa, ka për tu shtruar rruga dhe ka me u trasuar në gjatësi prej 1.5km, ketë e kam premtuar edhe para kësaj mbledhje, dhe kjo rugë ka me u përfunduar para datës së përvjetorit "Ditët e Luftës së Zharres".

znj.Blerta Syla, përshendetje per te gjithë, unë në mbledhjet e kaluara kam berë ankesë për ndriqimin ne lagjen "Goçaj", dhe këtu në ketë listë po e shoh se nuk është, poashtu në ketë pjesë ka nevojë, nga ura e Erenikut e deri te pllaka "Avdi Goçi" ruga është shumë e dëmtuar dhe kërkoj që të meret parasyshë renovimi i kësaj rruge, poashtu të ndërtohet nje muri mbrojtës po në ketë pjesë në rrugën Avdi Goçi.

z.Alfred Gaxherri, a ka mundsi ta kemi projekti e rrugës së "Zharres", sepse ky projekt nuk figuron ne ketë listë.

z.Lulzim Gacaferi, drejtor ju thatë se mbrenda dy ditëv fillojnë punimet në rrugën për në Zharre, dhe unë dua të di se a do ta përfundoni ketë rrugë me datën 27 Korrik? Sepse me datën 28 Korrik është pervjetori i Betejes se Zharres.

z.Zenun Shala, projekti ka qenë projekt dy vjeqar dhe operatori ekonomik na ka premtuar se do ta përfundoj para afatit.

z.Arten Hamza, ky projekt është projekt me bashkëfinancim, qe bashkëfinancohet me Qeverin Qendrore dhe eshte ne listën e projekteve te bashkefnacuara, edhe një sqarim, nuk jemi duke folur për projekte që ti buxhetojmë për vitin 2027, por për projekte qe me i futur n KAB, dhe ne shtator dihen se cilat projekte hynë në buxhet për vitin 2027 dhe prioritetet për vitin 2028,2029, dhe unë ju kisha inkurajuar që të bëni kërkesa , qoftë përmes emailit, apo drejtoris përkatëse ti adersoni kërkesën për ndonje projekt që ju keni interes te perfshini në ketë kornizë afatmesme, dhe ne si grup punues do ti permbledhim të gjitha kërkesat dhe deri në shtator do ta finalizojmë si listë te projekteve.

z.Burim Kuçi, sipas juve këto kërkesa që ne i bemë këtu nuk parashihen aspak, po u dashka që të marim pjesë në ndëgjime publike ose të bejmë kërkesë me shkrim apo kërkesat që parashtruam këtu n mbledhje nuk po u merkan për bazë.

z.Arten Hamza, kërkesat nëse janë dikush ka i mer me shkrim dhe ka titull të projektit mund të meret për bazë, por mirë do ishte që projekti të ketë titull, dhe të ketë një shumë të përafërt se sa mund të ketë kosto dhe ne ta vendosim në listë, nese procesmbajstesi i ka evidentuar këto kërkesa ne mund ti perfshimë në listë.

z.Leonard Llolluni, kërkesë tjetër nuk ka e qes në votim kornizën afatmesme buxhetrore 2027-2029 kush është për? për 5 vota, 1 votë kundër, dhe 5 vota abstenim.

Më pas Kryesuesi konstatoi se kjo pikë nuk u miratua, pati ndeëhyrje nga z.Shpejtim Gacaferi se me 5 vota për dhe 5 abstenime e 1 votë kundër pika miratohet, atëherë Kryesuesi i Kuvendit u deklarua se vota e tij eshtë kundër.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit nderkomunale per menaxhimin e integruar te mbeturinave PNMIM, per pese Komunat e Rajonit te Dukagjinit,

Sqarimin deh arsyetimin e planit nderkomunale per menaxhimin e integruar te mbeturinave PNMIM per pese komunat e Rajonit te Dukagjinit e beri z.Demokrat Ganijaj- drejtor në DSHPMSI.

z.Leonard Llolluni, kerkesë nuk ka, e qes në votim ketë pikë- planin nderkomunal për menaxhimin e e integruar ndërkomunal mbeturinave, kush është per? Për 10 vota, kundër 1 votë, dhe abstenim 0 vota, konstatoi se plani nderkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave u miratua.

5. Rishqyrtimi i Vendimit me nr:2-180/3155, per miratimin e plotësim ndryshimit të projekt-rregullores per menaxhimin e mbeturinave, miratuar nga Kuvendi i Komunës së Junikut,

Sqarimin dhe arsyetimin e bëri z.Leonard Llolluni-Kryesues i Kuvendit te Komunës së Junikut.

z.Leonard Llolluni, kerkese nuk ka, e qes ne votim rishqyrtimin e vendimit të menaxhimin e integruar tëmbeturinave, kush është për? per 10 vota, kundër 1 votë, dhe abstenim 0 vota, konstatoi se rishqyrtimi i vendimit me nr:2-180/3155 u miratua.

6. Raportimi i procesit te legalizimit, si dhe vendimi i Ministrisë për zgjatjen e afatitit të legalizimit për vitin 2026,

Sqarimin dhe arsyetimin e raportit te procesit te legalizimit dhe vendimin e ministrisë për zgjatjen e afatit të legalizimit për vitin 2026 e bëri z.Zenun Shala- Drejtor në drejtorinë DUKM,

z.Lulzim Gacaferi, faleminderit drejtor për këto sqarime, e ceket se zona e parë paguan 1€ për metër katrorë, sa është pagesa për zonen e tretë.

z.Zenun Shala, zonën e tretë, komuna nuk e trajton, por e trajton ministria.

z.Lulzim Gacaferi, gjatë diskutimeve qe keni pasur me ministrinë a keni paraparë që qytetarëve të komunës së Junikut te ju mindsoni që stanet e tyre të përfshihen ne zonën e tretë ashtu siç ju ka mundësuar kryetari i Komunës së Deçanit, me energji elektrike me rrugë të asfaltuara me të gjitha të mirat, a e keni ndërmend ta merni ketë inspirim, që ne qyetarët e këtij vendi të krenohemi me ju.

z.Zenun Shala, kjo pyetje është shumë me rëndësi për ne, mirëpo kur është formuar plani hapësinorë për bjeshkët e nemura në vitin 2023, komuna jonë ka pasur në ketë staf një delegat, z.Xhemë Shheu, i cili ka ndërruar jetë, dhe që nga vdekja e tij ne kemi mbetur pa përfaqësim, zona e tretë është përcaktuar pa prezencen e perfaqësuesit të komunës se Junikut, kur kemi ardhur ne pushtet e kemi formuar zonën e tretë dhe e kemi derguar te ky grup, mirëpor ky plan nuk ka hyrë në ketë plan hapësinor i cili është i vlershëm që nga viti 2023, aty ne kemi pasur një shkputje e qe ka sjellur pasoja, drejtor ka qene nje Nushi te cilit unë personalisht ja kam dërguar edhe në CD kërkesen dhe ai na ka premtuar se do ta fusin ne planin hapësinor, dhe tani po presim që te bëhet rishikimi i planit hapsinor dhe do te mundohem qe te fusin në ketë plan edhe zonën e tretë të komunes tonë.

7. Të ndryshme

z.Shpejtim Gacaferi, po mundona ti përfshij të gjitha në një fjalim, ku sipas meje kaloj korniza afatmesme buxhetore, ndërsa sipas jush nuk kaloj, unë kërkoj nga ju që kur ta përgaditini vendimin, si te doni ju a te kalon a po nuk kalon, por ati vendimi të bashkangjitni edhe listen e miratimit të akteve listën me numrin e votave, kërkoj nga ti qe ta qitesh 5,5, 1 sepse ashtu ishte, përndryshe do ishte mirë të konsultohi edhe me rregulloren e punës së kuvendit, në të kundërten si shef i grupit të LDK_se, ndjej obligim me kërkuar një interpretim nga ministria gjegjësisht nga zyrtarët e ministrisë që e moniterojne punën e kuvendit, që i ftoj të ndjekin edhe ingjizimin e kuvendit se si ka rrjedhur votimi për pikën e rendt të ditës numër tre. Ndersa sa i përket gjendjes së salles se kuvendit, anëtarët e kuvendit kanë të drejtë për gjendjen e sotit të sallës së kuvendit, mirëpor edhe në të kaluaren kemi pasur raste ta kemi nje gjendje jo te mire sallen e kuvendit, dhe Aulëset dhe kam berë regullimin e tyre.

z.Burim Kuçi, une edhe ne mbledhjet e kalurara kemi kërkuar nga drejtorët dhe nga kryetari që kerkesat tona të përfillen sepse janë në të mirren e qytetarëve dhe nëse kerkesat tona anashkalohen atëherë do te vimë në ketë gjendje që të mos e kalojmë as PIP siç nuk kaloj sot, drejtoreshë ne kërkesat tona i parashtruam këtu para kuvendit, kemi berë kërkesa edhe me shkrim në drejtoritë përkatëse dhe në zyret e komunës dhe nëse hasim në mirëkuptim dhe i perkrahni ato projekte te cilat janë në sherbim të qytetarëve ne atëherë se padyshim do të bashkëpunojmë së bashku, përndryshe nëse na injoroni kështu siç po na injoroni tash e gjashtë muaj,A nuk do te keni bashkëpunimin tonë.

z.Leonard Llolluni, e shpalli të mbyllur mbledhjen e qershorit 2026.

Procesmbajtësi:
z. Esat Hoxha

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard Llolluni